



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 148

Tiranë – E hënë, 4 nëntor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nr. 704, datë 21.10.2019	Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge 2019–2021..... 12163
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 151, datë 14.10.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Elva 2001” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kW..... 12189
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 152, datë 14.10.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar, me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016 të bordit të ERE-s, “Për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli”..... 12191
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 153, datë 21.10.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Electral Batra HPP” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 12194



VENDIM
Nr. 704, datë 21.10.2019

Sot, më datë 3.9.2019, u mbledh Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, i cili

VENDOSI:

1. Miratimin e “Planit Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë Fëmijët në Situatë Rruge 2019–2021”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Për monitorimin e zbatimit të “Planit Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë Fëmijët në Situatë Rruge 2019–2021”, ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bashkitë, Avokati i Popullit, organizatat jofitimprurëse, anëtare të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të cilat kanë detyrime për realizimin e objektivave dhe masave të parashikuara në këtë plan.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KËSHILLIT KOMBËTAR PËR
TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS**
Ogerta Manastirliu

**PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT
PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE
NGA SHFRYTËZIMI EKONOMIK,
PËRFSHIRË FËMIJËT
NË SITUATË RRUGE
2019–2021**

PËRMBAJTJA

I. HYRJE

II. SHKURTIME

III. PËRKUFIZIME

**IV. PARIMET MBI TË CILAT MBËSHTETET
PLANI I VEPRIMIT**

**V. PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TË
VEPRIMIT DHE METODOLOGJIA E
PËRDORUR**

**VI. GJETJET NGA ANALIZA DHE STUDIMI
I SITUATËS**

**VII. SYNIMET STRATEGJIKE DHE
OBJEKTIVAT SPECIFIKE**

VIII. KORNIZA E PLANIT TË VEPRIMIT

Aneks 1. Dokumentacioni i marrë në shqyrtim

Aneks 2. Lista e informatorëve kyç

I. HYRJE

Plani Kombëtar i Veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge reflekton angazhimin e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore për të parandaluar, identifikuar dhe ofruar mbrojtje për çdo fëmijë i cili ndodhet në rrezik apo në situatë shfrytëzimi ekonomik përfshirë fëmijët në situatë rruge në Republikën e Shqipërisë.

Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik është parashikuar në ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, duke i dhënë mbrojtje të veçantë kësaj kategorie dhe detyrimi i hartimit dhe zbatimit të Planit Kombëtar vjen nga Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 372, datë 26.4.2017.

Ky plan është hartuar pas një procesi konsultimi gjithëpërfshirës ndërsektorial, ku janë përfshirë aktorë nga institucionet qendrore dhe vendore si dhe organizatat partnere e në mënyrë të veçantë fëmijët. Plani Kombëtar i Veprimit ka qasje të bazuar në të drejta (përfshirë por jo vetëm parimet e pjesëmarrjes, barazisë-mosdiskriminimit, interesit më të lartë të fëmijës, jetës dhe zhvillimit në një mjedis miqësor për fëmijën, llogaridhënies ndaj fëmijës) duke bërë që të gjitha ndërhyrjet e propozuara të jenë në zbatim të të drejtave të fëmijës.

Qëllimi i planit është garantimi i të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge nëpërmjet parandalimit, ngritjes së shërbimeve dhe fuqizimin e zbatimit të legjislacionit duke siguruar mbrojtjen e fëmijëve viktime të shfrytëzimit ekonomik.

Që prej vitit 2014, kur ka filluar puna në mbrojtje të fëmijëve në situatë rruge, kemi rezultate pozitive në rritjen e bashkëpunimit mes institucioneve në identifikimin dhe menaxhimin e rasteve në nevojë për mbrojtje, në plotësimin e kuadrit ligjor dhe ngritjen e strukturave për mbrojtjen e fëmijëve. Por, pavarësisht këtyre arritjeve hasen ende shumë vështirësi dhe lind nevoja për ndërhyrje të vazhdueshme, afat-gjata



dhe të integruara në kuadër të një qasjeje sistematike për mbrojtjen e fëmijëve.

Ky dokument është produkt i një analize të kujdesshme të situatës aktuale të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve përfshirë fëmijët në situatë rruge, arritjeve të deritanishme në zbatim të planeve të veprimit për fëmijët në situatë rruge, të problemeve dhe të sfidave që kemi përpara dhe kërkon angazhim të të gjitha strukturave për të minimizuar fenomenin e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve.

Plani Kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik është hartuar me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Ekspertët që kanë punuar për hartimin e planit janë: z. Zini Kore (ekspert i pavarur), znj. Rajmonda Duka (eksperte e buxhetimit), znj. Jonita Kabashi (koordinatore pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës). Procesi i hartimit të planit u drejtua nga znj. Merita Xhafaj, drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe znj. Juliana Rexha, Drejtuese e Sektorit Antitrafikim pranë Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, e cila udhëhoqi grupin e punë, konsultimet dhe mori pjesë dhe në hartimin e planit.

Gjithashtu kontribut të çmueshëm në hartimin e dokumentit kanë dhënë profesionistë të mbrojtjes së fëmijës, Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës, punonjës të organizatave të cilët angazhohen çdo ditë të vitit në garantimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Vend të veçantë në hartimin e këtij plani kanë fëmijët, të cilët kanë dhënë këndvështrimin dhe rekomandimet e tyre në intervistat dhe fokus grupet e zhvilluara me ta.

II. SHKURTIME

ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
AKDF	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
DKM	Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit
DRSHSSH	Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial
ILO	Organizata Ndërkombëtare e

	Punës
ISHPSHSH	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore
IRPF	Institucione Rezidenciale të Përkujdesit për Fëmijë
MARS	Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës
NJVRN	Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave
NJV	Njësi vendore
OJF	Organizatë jofitimprurëse
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PMF	Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror

III. PËRKUFIZIME

A) *Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik*: Sipas nenit 24, të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e Fëmijës”, Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, sipas parashikimeve të Kodit Penal, që përfshin kryerjen e çdo pune që:

- paraqet rreziqe për shëndetin fizik dhe mendor, mirëqenien e zhvillimin e tij tërësor;
- cenon edukimin;
- është e detyruar.

2. Ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Fëmija mund të kryejë punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin, formimin e tij ose e largojnë atë nga shkolla, sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Punës.

3. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, si dhe nga kryerja e çdo pune të detyruar brenda familjes së tij, në shkollë, institucione të rehabilitimit dhe dënimit, ose në aktivitete kulturore, artistike, sportive, modelimi ose për qëllime reklamuese, që paraqet rrezik, cenon edukimin, dëmton shëndetin ose zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.

4. Ndalohet çdo praktikë, nëpërmjet së cilës fëmija detyrohet të kryejë veprime të përmendura në pikat 2 e 3, të këtij neni, pavarësisht dijenisë ose jo të prindit ose kujdestarit, si dhe pavarësisht faktit nëse është apo jo kundrejt shpërblimit.

5. Në rast se një fëmijë, brenda moshës për të cilën parashikohet arsimi i detyrueshëm, shmang



arsimimin, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të ndaluara, sipas ligjit, personeli arsimor njofton menjëherë prindin ose kujdestarin, si dhe njësinë e mbrojtjes së fëmijës, të cilët marrin masa të menjëhershme që fëmija të rikthehet në shkollë.

B) *Fëmijë në situatë rruge*. Sipas Komentit të Përgjithshëm nr. 21 të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, përfshihen:

a) fëmijët që varen nga rruga për të jetuar dhe / ose punuar, qofshin vetëm, me bashkëmoshatarët ose me familjen;

dhe b) një popullsi më të gjerë fëmijësh të cilët kanë formuar lidhje të forta me hapësira publike dhe për të cilët rruga luan një rol jetësor në jetën dhe identitetin e tyre të përditshëm.

Kjo popullsi e gjerë përfshin fëmijët që në mënyrë periodike, por jo gjithmonë, jetojnë dhe/ose punojnë në rrugë dhe fëmijët që nuk jetojnë apo punojnë në rrugë, por që rregullisht shoqërojnë bashkëmoshatarët, vëllezërit e motrat apo familjen në rrugë. Për sa u përket fëmijëve në situatë e rruge, “të qenit në hapësira publike” kuptohet të kalojë kohë të konsiderueshme në rrugë, parqet publike, hapësirat e komunitetit publik, sheshet dhe stacionet e autobusëve dhe trenave. Nuk përfshin ndërtesat publike siç janë shkollat, spitalet apo institucionet e tjera të krahasueshme.¹

IV. PARIMET MBI TË CILAT MBËSHETETET PLANI I VEPRIMIT

Plani ka qasje bazuar në të drejtat e fëmijës (përfshirë por jo vetëm parimet e pjesëmarrjes, barazisë-mosdiskriminimit, interesit më të lartë të fëmijës, jetës dhe zhvillimit në një mjedis miqësor për fëmijën, llogaridhënies ndaj fëmijës). Kjo do të sigurojë që të gjitha ndërhyrjet e propozuara të kenë tërësisht të integruar zbatimin e të drejtave të fëmijës.

Politikat e mbrojtjes së fëmijëve respektohen përgjatë hartimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve pjesë e këtij plani.

Plani zhvillohet në zbatim të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës dhe duhet të jetë i integruar dhe në zbatim tërësisht të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e fëmijës.

Plani është në përputhje me Konventat ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës

- Konventa për të Drejtat e Fëmijës

- Konventa nr. 38 e ILO-s “Për Moshën Minimale për Punë”

- Konventa nr. 182 e ILO-s “Për Format më të Rënda të Punës së Fëmijës”

- Komenti nr. 21, i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, për Fëmijët në Situatë Rruge

- Plani është hartuar dhe zbatohet mbi parimin e koordinim-bashkëpunimit në mënyrë që të evitohet mbivendosjet, qasjet e bazuara në projekte si edhe të maksimizojë ndikimin në përmirësimin e cilësisë së jetës të fëmijëve.

V. PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT DHE METODOLOGJIA E PËRDORUR

Plani Kombëtar i Veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge është hartuar në ndjekje të hapave si më poshtë:

Në fillim të procesit të hartimit të planit kombëtar të veprimit është organizuar një takim koordinues në MSHMS për të bashkërenduar hapat, përcaktuar afatet kohore dhe përgjegjësitë e palëve.

Procesi vijoi me identifikimin dhe kontaktimin e profesionistëve dhe institucioneve të ngarkuar me përgjegjësi, me eksperience të gjatë dhe kontribut të madh në adresimin e problematikave që kanë të bëjnë me shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve dhe fëmijët në situatë rruge. Këta profesionistë morën pjesë në hartimin e planit, duke kontribuar në validimin e metodologjisë dhe Draft Kornizës Logjike të planit, për mbledhjen dhe validimin e informacioneve, si edhe në propozimin dhe validimin e ndërhyrjeve. Bashkangjitur në aneksin 2 do të gjeni listën e plotë të profesionistëve të përfshirë në hartimin e planit

Mjetet e përdorura për hartimin e planit përfshijnë, shqyrtimin e dokumentacionit, tryezat teknike, fokus grupet me profesionistë dhe fëmijë, intervistat me profesionistë dhe fëmijë, si edhe pyetësor me profesionistë të fushës.

Në kuadër të analizimit dhe të studimit të situatës aktuale të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve përfshirë fëmijët në situatë rruge u konsultuan dokumentet që gjenden të listuara në aneks 1 Dokumentacioni i marrë në shqyrtim.

¹ Komenti i Përgjithshëm 21 i KDF-së, për fëmijët në situatë rruge, 2017

Dy tryeza teknike u realizuan me qëllim validimin e objektivave, kornizës dhe mjeteve për hartimin e planit si edhe për finalizimin e planit.

Pyetësi për mbledhjen e informacionit i sugjeruar në tryezën e parë teknike u përgatit dhe u nda me strukturat në varësi të Ministrisë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës, organizatat që punojnë me fëmijët në situatë ruge dhe viktime të shfrytëzimit ekonomik, si edhe me Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Drejtorive të Kufirit dhe Migracionit nëpërmjet zyrë së Koordinatorit Kombëtar Antitrafik. Pyetësin e kanë plotësuar 36 njësi për mbrojtjen e fëmijës, 6 DVP dhe një DKM, 5 institucione rezidenciale për fëmijë, 10 drejtori rajonale të shërbimit social shtetëror, 3 OJF (dy qendra ditore të së njëjtës organizate).

U realizuan 15 intervista me profesionistë të mbrojtjes së fëmijëve, si dhe me fëmijë viktime të shfrytëzimit ekonomik dhe fëmijë në situatë ruge, tashmë të integruar. Gjithashtu u realizuan 3 fokus grupe; 1 me profesionistë (17 pjesmarrës; dhe dy fokus grupe me fëmijë; fokus grupi i parë me fëmijë të grupit të mbrojtjes së fëmijëve. Fokus grupet me fëmijë u lehtësuan dhe organizuan nga organizata WV.

Në shtator 2019, plani është konsultuar në Këshillin Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ku përfaqësues të ministrive, organizatave anëtare të këshillit dhe fëmijë dhanë komentet mbi përmbajtjen e objektivave të planit.

Pas reflektimit të komenteve dhe sugjerime të tyre draft plani është ndarë për këshillim me institucione shtetërore dhe OJF që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve e në veçanti me fëmijët viktime të shfrytëzimit ekonomik përfshirë fëmijët në situatë ruge.

VI. GJETJET NGA ANALIZA DHE STUDIMI I SITUATËS

1. Aktivitetet në të cilat fëmijët në rrezik apo viktime të shfrytëzimit ekonomik përfshirë fëmijët në situatë ruge

Vlerësimi i situatës aktuale nuk ka pasur si qëllim në vetvete të nxjerrë shifra të sakta të fëmijëve në rrezik apo viktime shfrytëzimit ekonomik përfshirë fëmijët në situatë ruge. Shifrat e pasqyruara në tabelën 1 janë mbledhur nga të dhënat e raportuara pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe skuadrave të terrenit të ngritura për identifikimin dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht. Të dhënat më poshtë janë shifrat në total për çdo vit dhe nuk mund të mblidhen me njëra-tjetrën pasi disa prej rasteve të fëmijëve të identifikuar janë përsëritës.

Tabela 1: Fëmijë të identifikuar në situatë shfrytëzimi ekonomik nga Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Skuadrat e terrenit për periudhat 2016–2017–2018

Periudha	Raste të identifikuara në situatë shfrytëzimi ekonomik (total për vit)	Llojet e shfrytëzimit	Numri rasteve të identifikuara sipas indikatorëve
2016	578	Fëmijë në situatë lypje	543
		Fëmijë të përfshirë në punë informale në rrugë	9
		Fëmijë që shesin materiale	26
		Fëmijë të identifikuar viktime të mundshme trafikimi ose viktime trafikimi	0
		Fëmijë në konflikt me ligjin	0
2017	372	Fëmijë në situatë lypje	309
		Fëmijë të përfshirë në punë informale në rrugë	29
		Fëmijë që shesin materiale	2
		Fëmijë të identifikuar viktime të mundshme trafikimi ose viktime trafikimi	15
		Fëmijë në konflikt me ligjin	0
2018	305	Fëmijë në situatë lypje	256



	Fëmijë të përfshirë në punë infonmale në rrugë	16
	Fëmijë që shesin materiale	19
	Fëmijë të identifikuar viktime të mundshme trafikimi ose viktime trafikimi	12
	Fëmijë në konflikt me ligjin	1

Këto shifra japin një panoramë të përafërt të situatës. Për të pasur një pasqyrë të qartë me shifra të sakta duhet kryer një studim i thelluar i situatës së shfrytëzimit të fëmijëve përfshirë fëmijët në situatë rrugë.

Nga viti 2016 deri në 2018 vërehet një ulje e numrit të fëmijëve të identifikuar në situatë shfrytëzimi ekonomik (52.7%), kjo si rrjedhojë e ndërhyrjeve të koordinuara në procesin e menaxhimit të rasteve, rritjes së shërbimeve në territor, forcimit të kapaciteteve të profesionistëve dhe një rol të veçantë miratimi dhe zbatimi i planeve lokale për fëmijë në situatë rrugë në bashkitë më të mëdha të vendit (Durrës,

Shkodër, Fier, Vlorë, Elbasan, Korçë dhe Tërana (draft)). Numrin më të lartë të rasteve të identifikuar janë fëmijët në situatë lypje dhe në dy vitet e fundit vërehet një rritje në identifikimin rasteve të fëmijëve viktime të mundshme dhe viktime trafikimi.

2. Shkaqet kryesore

Në tabelën nr. 2 janë të pasqyruara shkaqet kryesore të situatës aktuale të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve përfshirë fëmijët në situatë rrugë, ku në renditje nr. 1 tregon shkakun më të rëndësishëm dhe nr. 8 shkakun më pak të rëndësishëm.

Tabela 2. Shkaqet kryesore të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve përfshirë fëmijët në situatë rrugë

Shkaqet kryesore	
a) Barriera shoqërore, kulturore, diskriminimi, përjashtimi	6
b) familje në lëvizje, fëmijë në lëvizje	5
c) situata sociale e familjes (fëmijë pa kujdes prindëror, me një prind etj.)	3
d) dhuna/abuzimi/neglizhimi/	2
e) shëndeti (aftësi mendore ose fizike e kufizuar)	7
f) arsimimi (frekuentimi/mosfrekuentimi i institucioneve arsimore)	4
g) varfëria (papunësia, mungesa e strehimit, mos plotësimi i nevojave bazë)	1
h) sistem i mbrojtjes së fëmijës i dobët	8
i) tjetër: fëmijët nxjerrin më shume të ardhura se të rriturit nga lypësia	

Varfëria është shkak kryesor i situatës aktuale të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve përfshirë fëmijët në situatë rrugë. Ky shkak ka dalë jo vetëm nga analiza e të dhënave të pyetësorëve, por edhe nga të dhënat e mbledhura nga intervistat, fokus grupet si edhe shqyrtimi i dokumentacionit.

3. Faktorët që ndikojnë për keq në përmirësimin e situatës aktuale

Tabela 3. Faktorët që ndikojnë për keq

Faktorët që ndikojnë për keq në përmirësimin e situatës	
a) nevoja për përmirësime ligjore të mëtejshme	8
b) mungesë shërbimesh për shkak të moszbatimit të ligjeve ekzistuese	4
c) mungesë buxhetesh/parash	3
d) mungesë koordinimi midis aktorëve social	5
e) stigmatizimi i fëmijëve të shfrytëzuar ekonomisht apo në situatë rrugë ul aksesin në shërbime	6
f) situata familjare (familjet nuk mund të aksesojnë shërbimet ose nuk inkurajojnë fëmijët e tyre ta bëjnë këtë)	2
g) mungesë ndërgjegjësimi ndërmjet fëmijëve të shfrytëzuar ekonomisht apo në situatë rrugë rreth të drejtave të tyre dhe shërbimeve ekzistuese	7
h) kriza ekonomike (më shumë fëmijë të shfrytëzuar ekonomisht apo në situatë rrugë për shkak të varfërisë)	1
i) tjetër	



4. Masat urgjente për të përmirësuar kushtet e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht:

Ndërhyrje urgjente	
a) përmirësime/plotësime të bazës ligjore	8
b) mbledhje fondesh ose korigjimi i alokimit të buxheteve	1
c) rritje e ndërgjegjësimit mes institucioneve për boshllëqet dhe çështjeve kritike	4
d) trajnim i shumë agjencive për të rritur koordinimin	5
e) rritje e ndërgjegjësimit mes familjeve dhe fëmijëve për të rritur fuqizimin /kapacitetet proaktive	3
f) më tepër ndërhyrje për të inkurajuar fëmijët të aksesojnë shërbimet në mënyrë të pavarur	6
g) ndërhyrje më direkte nga shërbimet sociale dhe zbatimi i ligjit	2
h) ndërhyrje direkte nga OJF	7
i) tjetër: marrje e masave të menjëhershme, pa shumë burokraci, përshpejtim masash	

5. Vështirësitë kryesore me të cilat ndeshen strukturat e mbrojtjes së fëmijëve për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik

Vështirësitë kryesore të hasura gjatë punës në identifikimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht	
a) mungesa e programeve specifike të institucionit tuaj për këtë grup fëmijësh	2
b) mungesa e koordinimit të ndërhyrjeve në teren	3
c) mbingarkesa në punë	5
d) nuk është në detyrat tuaja funksionale	7
e) mungesa e buxheteve/fondeve	1
f) mungesa e terminologjisë dhe treguesve për këtë grup fëmijësh	6
g) mungesat e kapaciteteve të stafit për të trajtuar këtë grup fëmijësh	4
h) mungesa e llogari dhënies	8
i) tjetër: - Gjetja e mundësive për akomodimin afatgjatë të përfituesve që nuk mund të kthehen në familjet e origjinës; - Vlerësimi i familjeve dhe gjetja e vendbanimeve alternative për të miturit; - Trajtimi i rasteve me probleme shëndetësore mendore dhe fizike; - Trajtimi i çështjes së komplikuar të stigmës sociale - mungesa e feedback-ut pasi raportohen për menaxhim rastet e identifikuara - Mungesa e bashkëpunimit të familjeve. - Prindër shfrytëzues. - Prindër dembelë	

6. Faktorët prioritarë për të përmirësuar aksesin e fëmijëve në shërbime për ta

Faktorët prioritarë për të përmirësuar aksesin e fëmijëve në shërbime për ta	
a) shërbimet janë vendosur më afër fëmijëve	1
b) fëmijët janë më të ndërgjegjësuar për shërbimet	6
c) familjet janë më të ndërgjegjësuar për shërbimet	2
d) ka më shumë shërbime për plotësimin e nevojave specifike	5
e) dënimi i shfrytëzuesve apo kundërvajtësve administrativë	3
f) shërbime më miqësore dhe më pak burokratike	4
g) koordinimi midis shërbimeve sociale dhe shërbim ofruesve të tjerë për referim në qendrat ditore and “vice versa”	7
h) shërbimet sociale janë më të ndërgjegjësuar a për të rëndësishme të shërbimeve të duhura ditore për fëmijët	8
i) tjetër: rastet të ndiqen për një kohë të gjatë në bazë nevojash jo të “braktisen deri sa të vijnë përsëri vetë pranë zyrave”	



7. Elementët më të rëndësishëm për përmirësimin e analizës dhe mbledhjes së të dhënave për të ndikuar politikëbërësit qendrorë, rajonalë, vendorë për ndërhyrje institucionale më efikase ndaj fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge

Elementët për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave	
a) Njohja e mekanizmave ekzistues	4
b) Ngritja e një database të unifikuar	1
c) Njehsimi i terminologjisë	7
d) Bashkërendimi midis aktorëve të përfshirë	2
e) Zbatimi i legjislacionit për bashkërendim	3
f) Ngritje kapacitetesh për mbledhje dhe analizim të dhënash	5
g) Strategjitë dhe politikat që ndërtohet mbi bazën e të dhënave	6
h) Mbledhje dhe analizim të dhënash ndërsektoriale	8
i) tjetër:	

VII. SYNIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Qëllimi i planit është garantimi i të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge nëpërmjet parandalimit, ngritjes së shërbimeve dhe fuqizimin e zbatimit të legjislacionit duke siguruar mbrojtjen e fëmijëve viktime të shfrytëzimit ekonomik.

Objektivi i përgjithshëm është: *Fëmijët në Shqipëri janë të mbrojtur nga të gjitha format e shfrytëzimit ekonomik!*

Objektivat specifikë të planit janë:

Objektivi 1: Të parandalojë shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve, përfshirë fëmijët në situatë rruge.

Objektiv 2: Të sigurohet mbrojtje dhe ndërhyrje sipas nevojave për fëmijët në rrezik apo në shfrytëzim ekonomik.

Objektiv 3: Rritja e numrit të çështjeve penale të suksesshme në lidhje me shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve, detyrimin për të punuar; Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nga strukturat ligjzbatuese.

Objektiv 4: Barrierat shoqërore dhe kulturore që nxisin shfrytëzimin ekonomik janë ulur.



VIII. KORNIZA E PLANIT TË VEPRIMIT

Objektivi 1 Të parandalojë shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve, përfshirë fëmijët në situatë rruge Mjetet për të arritur objektivin: Hartimi i databazës kombëtare, analizë situatë, rishikim procedurash, përgjegjësish, përshkrimesh pune, trajnime, mentorim, takime ndërgjegjësuere, miratim kodi etik për punësim të personave nën 18 vjeç.									
Nënobjektivi 1 Mbledhja e të dhënave në nivel kombëtar për mbrojtjen e fëmijës dhe menaxhimi i regjistrit elektronik kombëtar për rastet e shfrytëzuar ekonomisht/përfshirë fëmijët në situatë rruge Organi/et MSHMS, ASHMDF, DSHSB, SHSS, ISHPShSh, NJMF-të, OJF-të,									
Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pa mbuluara	
1. Studim kombëtar mbi situatën e punës së fëmijëve dhe fëmijët në situatë rruge në Shqipëri.	Përditësim i situatës së fëmijëve në shfrytëzim ekonomik në për situatën e shfrytëzimit ekonomik për t'u përdorur për planifikim zbatim dhe monitorim të situatës	Dokumenti i baseline	2020	2021					MSHMS, ASHMDF
2. Hartimi dhe miratimi i treguesve të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve sipas sektorëve, përfshirë fëmijët në situatë rruge.	Miratimi institucional i Udhëzimeve përkatëse me treguesit për shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve.	Tregues të miratuar	2019	2020					MSHMS, ASHMDF, ISHPSHSH, Policia e Shtetit
3. Krijimi dhe përditësimi i databazës së të dhënave për fëmijët, në nivel kombëtar dhe në çdo bashki.	ASHMDF dhe strukturat përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki kanë të dhëna të përditësuara të fëmijëve në shfrytëzim ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge.	Databazë e përditësuar	2019	Në vazhdim					ASHMDF



4. Monitorim i drejtpërdrejtë i mbledhjes dhe mbajtjes së të dhënave	Çdo bashki monitorohet mbi mbledhjen dhe mbajtjen e të dhënave	Raporte monitorimi të zbardhura	2019	Në vazhdim					ASHMDF
5. Përfshirja e planeve vendore për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik dhe FSRR në planet vendore të mbrojtjes së fëmijëve dhe me tej në planin vendor të mbrojtjes sociale në të gjitha bashkitë	Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik integrohet në strategjinë vendore të mbrojtjes së fëmijëve.	Planet në vetvete	2019	2020					MSHMS, SHSSH, ASHMDF

Nënobjektiv 2

Rritja e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve për zbatimin e masave të parashikuara në legjislacion dhe në mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve në shfrytëzim ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge.

Organi/et zbatues/e

ASHMDF, DSHSB, SHSH, DPPSh, SHSR, NJA, NJVRN, NJMF, OJF-t

Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pa mbuluara	
1. Përgatitja e një udhëzuesi metodologjik me përgjegjësitë, detyrimet dhe hapat e menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik apo viktime të shfrytëzimit ekonomik përfshirë fëmijët në situatë rruge.	Reflektim i detajuar i përgjegjësisë dhe veprimeve që duhet të ndërmarrin strukturat e mbrojtjes së fëmijës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik.	Përmbajtja e dokumentacionit të përgatitur.	2020	2021					MSHMS, ASHMDF



2. Ndarja e Udhëzuesit metodologjik (procedural) me të gjithë anëtarët e GTN-ve në shkallë vendi.	Çdo anëtar i GTNsë njihet përgjegjësitë sipas legjislacionit në fuqi.	Përmbajtja e dokumentacionit të përgatitur.	2020	2021					MShMS, ASHMDF
3. Trajtime ToT për NJMFT-të për rreziqet dhe mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik përfshirë fëmijët në situatë rruge.	NJMF kanë kapacitetet jo vetëm të sigurojnë mbrojtjen por edhe të ndihmojnë/trajnojnë PFM-të e tjera dhe punonjës të terrenit.	Nr. i NJMF të trajnuar, nr. I trajnimeve.	2019	2021					MShMS, ASHMDF, BASHKITE
4. Trajtime me PMF-të, Punonjësit Social, ndërmjetësit komunitarë, punonjës të NJVRN për rreziqet dhe mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik përfshirë fëmijët në situatë rruge.	Trajtime në nivel qarku me trajnime me PMF-të, punonjësit socialë, ndërmjetësit komunitarë, punonjës të NJVRN për rreziqet dhe mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik përfshirë fëmijët në situatë rruge	Nr. i punonjësve të trajnuar	2019	2021					MShMS, ASHMDF, BASHKITE
5. Trajtime me anëtarët e GTN-ve për rreziqet dhe mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik përfshirë fëmijët në situatë rruge.	Punonjësit në terren kanë kapacitetet dhe njohuritë e duhura për fëmijët viktime të shfrytëzimit ekonomik	Nr. i punonjësve të trajnuar	2019	2020					MShMS, ASHMDF, BASHKI



6. Takime periodike me Institucionin e Prefektit, bashkitë, mekanizmat për transparencën në industrinë nxjerrëse për përthithjen nga bashkitë të të ardhurave nga renta minerare dhe buxheti i shërbimeve për fëmijët nga të ardhurat nga renta minerare.	Rritja e të ardhurave vendore për shërbime të orientuara tek mbrojtja e fëmijëve.	Takime të realizuara	2019	2020					MSHMS, MEF, MET, MB, ASHMDF.
---	---	----------------------	------	------	--	--	--	--	------------------------------

Nënobjektiv 3

Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit të biznesit në lidhje me punën e fëmijëve

Organi/et zbatues/e

ASHMDF, DSHSB, SHSH, SHSR, NJA, NJVRN, NJMF, OJF-të

Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pa mbuluara	
1. Takime ndërgjegjësuere me bizneset e industrisë minerare.	Rritja e transparencës së biznesit në industrinë minerare për punësimin e fëmijëve.	Numri i takimeve ndërgjegjësuere	2019	Në vazhdim					MSHMS, MET, MEF, ASHMDF.
2. Aktivitete ndërgjegjësuere me bizneset dhe afishimi i kontakteve të NJMF-ve.	Bizneset kanë njohuritë për punët e rënda të fëmijëve dhe zbatojnë legjislacionin përkatës.	Nr. i bizneseve të ndërgjegjësuar	2019	Në vazhdim					MSHMS, ASHMDF, IShPShSh, BASHKI
3. Miratimi i kodit etik për punësimin e personave nën 18 vjeç.	Bizneset ndërmarrin zotim konkret për njohjen e legjislacionit për punësimin dhe mbrojtjen e personave nën 18 vjeç.	Numri i bizneseve që miratojnë kodin dhe marrin masa konkrete për zbatimin e tij	2019	2021					MSHMS, MEF, Dhomat e Tregtisë, Shoqatat e Biznesit, ASHMDF.

**Objektiv 2**

Të sigurohet mbrojtje dhe ndërhyrje sipas nevojave për fëmijët në rrezik apo në shfrytëzim ekonomik

Mjetet për të arritur objektivin: Ngritje dhe fuqizim i shërbimeve ditore, vlerësim situatë, monitorim situatë, plotësimi i nevojave bazë, përgjegjësia sociale e bizneseve, rritje kapacitetesh të strukturave të mbrojtjes së fëmijës.

Nënbjektiv 1

Organizimi i punës dhe identifikimi i rasteve të shfrytëzuar ekonomikisht/përfshirë fëmijë në situatë rruge.

Organi/et zbatues/e:

ASHMDF, NJMF-të, NJQV, bizneset, OJF-të

Aktivitete	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pa mbuluara	
1. Krijimi i hartës së zonave ku do të kryhet identifikimi i fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge.	Çdo bashki disponon një pasqyrë të saktë të zonave të frekuentuara nga fëmijët të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijë në situatë rruge.	Nr. i bashkive që disponojnë hartëzimin	2019	Në vazhdim	Kosto administrative				MSHMS, ASHMDf, BASHKITE
2. Ngritja e skuadrave të terrenit në çdo njësi vendore dhe punë në rrugë/terren sidomos në orët dhe mjediset e rrezikut të lartë.	Formalizimi i procesit të identifikimit dhe referimit.	Nr. i rasteve të identifikuar dhe nr. i rasteve të referuara.	2019	Në vazhdim					MSHMS, ASHMDf, BASHKITE
3. Identifikim dhe referim proaktiv i të gjitha rasteve të fëmijëve në rrezik të shfrytëzimit ekonomik përfshirë FSRR.	Fëmijët në rrezik shfrytëzimi ekonomik identifikohen në vendet ku ndodh shfrytëzimi ekonomik.	Nr. i fëmijëve të identifikuar dhe trajtuar.	2019	Në vazhdim					MSHMS, ASHMDf, BASHKITE
4. Sigurim i bazës materiale nga bashkitë dhe të tjerë për punonjësit që ofrojnë shërbime në terren.	Bashkitë sigurojnë buxhet specifik për funksionimin e skuadrave të terrenit.	Buxheti i bashkisë përmban zëra specifikë.	2019	Në vazhdim					MSHMS, ASHMDf, BASHKI



5. Pasqyrimi në databazën e identifikimeve të çdo rasti të identifikuar në situatë rruge.	Ekziston dokumentim i rregullt i çdo rasti të identifikuar dhe hapave të ndërmarra.	Nr. i rasteve dhe informacioni përkatës i rasteve regjistruar në databazë.	2019	Në vazhdim					MSHMS, ASHMDf, BASHKI
6. Trajnime dhe mbështetje teknike e vazhdueshme për skuadrat e terrenit.	Punonjësit e skuadrave të terrenit kanë kapacitete e nevojshme dhe mbështetjen e duhur profesionale përgjatë punës	Nr. i trajnimeve, mentorimeve, nr. i personave të trajnuar dhe mentoruar, nr. i rasteve të ndihmuara.	2019	Në vazhdim					MSHMS, ASHMDf, BASHKI

Nënobjektiv 2

Plotësimi i nevojave bazë ekonomike dhe sociale të fëmijëve dhe familjeve në rrezik apo viktime të shfrytëzimit ekonomik përfshirë FSRR

Organi/et zbatues/e

MSHMS, ASHMDf, DSHSB, SHSSH, NJMF-të, OJF-të,

Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pambuluara	
1. Ngritja e mekanizmave vendorë të ofrimit të ndihmës direkte (banka e ushqimeve, veshmbathjeve etj.).	Akresi i fëmijëve në ndihmë	Nr. i fëmijëve të ndihmuar.	2019	Në vazhdim					ASHMDf, BASHKI
2. Sigurimi i paketave bazë material.	Ndihma materiale jepet në kohë	Nr. i fëmijëve dhe familjeve	2019	Në vazhdim					ASHMDf, BASHKI
3. Hartimi dhe miratimi i standardeve për shërbimet ditore për fëmijët në situatë rruge.	Fëmijët përfitojnë shërbime cilësore të standardizuara	Vetë dokumenti i standardeve	2019	2020					ASHMDf, BASHKI
4. Fuqizimi i shërbimeve ekzistuese ditore të cilat kanë target fëmijë të shfrytëzuar ekonomikisht/përfshirë fëmijë në situatë rruge.	Rritja e cilësisë dhe kapacitetit të shërbimeve	Nr. i aktiviteteve fuqizuese	2019	2020					MSHMS, ASHMDf, BASHKI



5. Ngritja e shërbimeve të reja në bashkitë e identifikuar më nr. të lartë të fëmijëve viktime të shfrytëzimit ekonomik përfshirë FSRR.	Fëmijët i përfitojnë shërbime pranë zonave ku banojnë	Nr. i shërbimeve të ngritura, nr. i fëmijëve të cilët kanë marrë shërbime.	2019	2020					MSHMS, ASHMDF, BASHKI
---	---	--	------	------	--	--	--	--	-----------------------

Nënobjektiv 3

Akses i menjëhershëm në shërbimet mbrojtëse të emergjencës dhe shërbimet rezidenciale për çdo fëmijë dhe familje në rrezik apo viktimë e shfrytëzimit ekonomik

Organi/et zbatues/e

MSHMS, ASHMDF, SHSSH, NJQV, OJF-të, NJMF-të, DPSH.

Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pa mbuluara	
1. Hartimi dhe miratimi i standardeve për shërbimeve shoqërore/sociale të emergjencës.	Shërbimet shoqërore të emergjencës ofrohen në cilësinë e duhur	Standardet e miratuara	2019	2021					MSHMS, SHSSH
2. Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve shoqërore të emergjencës për çdo rajon dhe /ose çdo bashki përfshirë skuadrat e emergjencës, ndihmën materiale të nevojshme dhe shërbimet rezidenciale.	Fëmijët në rrezik të lartë kanë akses të menjëhershëm në shërbimet e emergjencës	Nr. i fëmijëve të trajtuar,	2019	2020					MSHMS, ASHMDF, SHSSH, BASHKI
3. Plane specifike dhe procedura të përbashkëta veprimesh për shërbime emergjence për çdo njësi të qeverisjes vendore.	Bashkëpunimi ndër institucional për mbrojtjen e fëmijëve është funksional në nivelin vendor	Planet dhe protokollat vendore të miratuara	2019	2020					MSHMS, ASHMDF, SHSSH, BASHKI
4. Menaxhimi i çdo rasti në situatë emergjence.	Çdo rast i identifikuar në rrezik të lartë dhe të menjëhershëm menaxhohet	Nr. i rasteve të menaxhuara	2019	2020					ASHMDF, SHSSH, BASHKI
5. Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të shërbimit të emergjencës për trajtimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht - përfshirë FSRR.			2019	2020					ASHMDF, SHSSH, BASHKI
6. Inspektimi, Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve të emergjencës.			2019	2020					ShSSH, IShPShSh, ASHMDF



7. Zhvillimi dhe zbatimi i programeve rehabilituese dhe riintegruar për fëmijët viktimë të shfrytëzimit ekonomik dhe FSRR që janë përfitues të shërbimeve rezidenciale.	Fëmijët në shërbimet e kujdesit rezidencial përfitojnë shërbimet e nevojshme	Nr. i fëmijëve të trajtuar, nr. i rasteve të rikuperuara	2019 2019	2020					AShMDF, SHSSH, BASHKI
8. Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të shërbimeve rezidenciale për trajtimin e fëmijëve viktimë të shfrytëzimit ekonomik përfshirë FSRR.		Progresi pozitiv zhvillimor i fëmijëve. Nr. i rasteve të riintegruara.	2019	2020					AShMDF, SHSSH, BASHKI
9. Rivlerësim i procedurave të deinstitutionalizimit dhe ndjekja e rastit pas daljes nga shërbimet e kujdesit rezidencial.	Fëmijët rriten në një mjedis miqësor për të dhe interesi më i lartë i tij/ e saj zbatohet.	Ulja e numrit rasteve të rikthyer në situatë shfrytëzimi	2019	2020					MSHMS, SHSSH,
Nënbjektiv 4 Akses i pakushtëzuar në arsimin parauniversitar dhe aktivitete shoqërore që ndihmojnë zhvillimin normal të fëmijës për çdo fëmijë në rrezik shfrytëzimi ekonomik Organi/et zbatues/e MASR, DAR ZA, ASHMDf, NJMF-të, OJF-të, shkollat									
Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pambuluara	
1. Punë në terren në të gjitha zonat e banuara dhe posaçërisht gjatë verës në zonat bregdetare, për identifikimin dhe sigurimin e regjistrimit dhe frekuentimit të shkollës.	Çdo fëmijë në moshë shkollore është i regjistruar dhe ndjek arsimin e detyrues dhe nuk rrezikohet nga shfrytëzimi ekonomik.	Ulja e numrit të fëmijëve të identifikuar që nuk shkojnë në shkollë.	2019	Në vazhdim					MASR, ASHDMF, BASHKITE
2. Plotësimi i nevojave të fëmijëve me libra dhe mjete didaktike përgjatë gjithë periudhës së vitit akademik.	Dinjteti dhe pjesëmarrja e fëmijës në edukim nuk kushtëzohen nga mungesa e materialeve	Nr. i fëmijëve të ndihmuar	2019	2020					MASR, ASHDMF,BAS HKI



3. Regjistrimi i fëmijëve në sistemin parashkollor.	Shqyrtimi i dokumentacionit, të gjithë fëmijët e identifikuar në shfrytëzim ekonomik/fëmijë në situatë rruge frekuentojnë sistemin parashkollor	Nr. i fëmijëve të regjistruar	2019	Në vazhdim					MASR, ASHDMF, BAS HKI
---	---	-------------------------------	------	------------	--	--	--	--	-----------------------

Nënobjektiv 5

Akses i pakushtëzuar në shërbimet shëndetësore dhe shoqërore për fëmijët në rrezik shfrytëzimi ekonomik përfshirë FSRR.

Organi/et zbatues/e

MSHMS, ASHDMF, Bashkitë, Qendrat Shëndetësore, NJVRN, NJMF

Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pambluara	
1. Punë në terren në të gjitha zonat e banuara për të siguruar vaksinimin dhe pajisjen me kartën e shëndetit të të gjithë fëmijëve rezidentë.	Çdo fëmijë në territor është i vaksinuar dhe ka kartë shëndeti	Ulja e numrit të fëmijëve të identifikuar si të pavaksinuar apo pa kartë shëndeti.	2019	Në vazhdim		X			MSHMS
2. NJVRN identifikojnë dhe referojnë në kohë të gjitha rastet e fëmijëve në rrezik shfrytëzimi ekonomik përfshirë FSRR me nevoja për shërbime shëndetësore, shoqërore dhe më gjerë.	Fëmijët përfitojnë në kohë shërbimet shëndetësore dhe shoqërore.	Nr. i fëmijëve që shërbehen përkundrejt nr. të fëmijëve që nuk kane akses	2019	Në vazhdim		X			MSHMS; BASHKI
3. Procedurat aktuale për aksesin në shërbimet shoqërore dhe shëndetësore rishihen për të mos penguar aksesin në shërbime nga fëmijët pavarësisht veprimeve apo mos veprimeve të të rriturve kujdestarë. PMF siguron aksesin kur nuk e bëjnë prindërit.			2019	2020					MSHMS; BASHKI



4. Bashkitë alokojnë buxhete dhe marrin masa nëpërmjet PMF dhe sigurojnë medikamente dhe trajtimin mjekësor falas për çdo fëmijë në rrezik shfrytëzimi ekonomik përfshirë FSRR	Vështirësitë financiare nuk ndikojnë në aksion e fëmijëve në shërbime shëndetësore dhe shoqërore	Nr. i fëmijëve të ndihmuar, sasia e buxhetit të alokuar.	2019	2020		X			MSHMS; BASHKI
5. Koordinim i shërbimeve psiko-sociale të bashkisë me shërbimet psikosociale të DAR dhe DSHP.	Shërbimet rikuperuese aksesohen nga të gjithë fëmijët në nevojë për to	Nr. i fëmijëve të trajtuar.	2019	2020	Kosto administrative				BASHKITË, DAR, DSHP
Nënbjektiv 6 Mbrojtja e Fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik në zonat përreth minierave. Organi/et zbatues/e ASHMDF, MSHMS, MIE, ISHPSHSH, firmat kontraktuese, sindikatat									
Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pambuluara	
1. Takime të nivelit të lartë me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve publikë dhe privatë të të gjitha niveleve.	Të gjithë aktorët njihen me situatën aktuale dhe gjithsecili merr përgjegjësitë e tij për ndërhyrjet në vazhdim.	Plani konkret i veprimit	2019	vazhdim	Kosto administrative				MSHMS, ASHMDF, Avokati i Popullit
2. Hartëzim i zonave pranë minierave me rrezikshmëri të lartë.	Zonat me rrezik të lartë janë identifikuar	Analiza e situatës	2019	2020	Kosto administrative				
3. Sigurimi fizik i perimetrit të minierave për ndalimin e hyrjes së fëmijëve duke i rrethuar dhe vendosur roje.	Fëmijët nuk hyjnë në zona me rrezikshmëri të lartë për shëndetin dhe jetën	Nr. i fëmijëve të identifikuar	2019	2020				Biznesi	MSHMS, ASHMDF, ISHPSHSH,
4. Vlerësim i situatës së fëmijëve dhe familjeve që punojnë pranë minierave	Ndërhyrjet ngrihen mbi bazën e të dhënave të sakta	Dokumentet e vlerësimit të situatës	2019	2019	Kosto administrative				MSHMS, ASHMDF,
5. Ngritja e shërbimeve me bazë komunitare për të plotësuar nevojat bazë të familjeve (përfshirë ushqim, veshmbathje, ndihma materiale etj.).	Fëmijëve ju plotësohen nevojat bazë	Nr. i fëmijëve të trajtuar, nr. i shërbimeve të ngritura	2019	Në vazhdim				X	Bashkitë



6. Plotësimi i nevojave ekonomike dhe sociale të familjeve të fëmijëve që punojnë rreth minierave.	Fëmijët nuk punojnë më për të plotësuar nevojat bazë personale dhe të familjeve të tyre		2019	Në vazhdim					
7. Ofrimi i shërbimeve dhe aktiviteteve argëtuese për fëmijët në qytetet apo vend banimet pranë minierave.	Fëmijët kalojnë kohën e lirë në mjedise dhe aktivitete miqësore për ta	Nr. i fëmijëve që marrin pjesë në aktivitete, nr. i fëmijëve që marrin pjesë në aktivitete jo të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin e tyre.	2019	Në vazhdim				X	
Nënbjektiv 7 Akses në punësim të familjeve të fëmijëve të identifikuar në situatë shfrytëzimi ekonomik. Organi/et zbatues/e MSHMS, ASHMDF, SHSSH, NJQV, OJF-të, NJMF-të, DPSH									
Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pa mbuluara	
1. Rritja e mundësive për punësim përmes krijimit të profileve për punëkërkuar dhe profile ofrues punësh në përshtatje me kapacitete të prindërve të fëmijëve të identifikuar në situatë shfrytëzimi ekonomik/situatë rruge.	Krijimi i mundësive konkrete punësimi	Numri i prindërve të punësuar	2019	2020	Kosto administrative		X		MEF, MShMS, BASHKITË, Shërbimi Kombëtar i Punësimit,
2. Pjesëmarrja e prindërve dhe të rinjve në programet e nxitjes së punësimit dhe në kurse të formimit profesional.	Hapja e kurseve dhe frekuentimi nga prindërit.	Numri i prindërve të fëmijëve në shfrytëzim ekonomik, të cilët ndjekin programet e nxitjes së punësimit dhe në kurse të formimit profesional	2019	Në vazhdim	Kosto administrative		X		MEF, MShMS, BASHKITË, Shërbimi Kombëtar i Punësimit,



3. Mundësimi granteve të vogla për familjet për t'i nxitur për vetëpunësim.	Fuqizimi i familjeve nëpërmjet granteve të vetëpunësimit	Numri i familjeve që kanë përfituar grante, nr. i familjeve të vetëpunësuar	2019	2020				
---	--	---	------	------	--	--	--	--

Nënobjektiv 8: Mbrojtja e fëmijëve nga format e rënda të punës dhe/nga punësimi i paligjshëm në sektorin formal.

Strategjitë për të arritur objektivat: Rritja e njohurive të inspektorëve të punës, përmirësimi i metodologjisë së inspektimit të punës së fëmijëve, rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional për shkëmbimin e informacionit dhe referimin e rasteve.

Organi/et zbatues/e: ISHPSHSH, ASHMDF, NJMFT-të, NJQV, bizneset, OJF-të

Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pa mbuluara	
1. Hartimi i metodologjisë së inspektimit të punës së fëmijëve.	Parandalimi i shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve dhe rritja e cilësisë së inspektimeve	Metodologjia miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e ISHPSHSH-së	2019	2020	3,000,000 Lekë		X		MShMS, Inspektoriat I Përgjithshëm, IShPSHSH
1. Përmirësimi i procedurave dhe cilësisë së inspektimeve.	Ulja e rasteve të fëmijëve në punësim të paligjshëm;	Rregulloret e ripara, inspektorët e trajnuar, nr. i përgjithshëm i inspektorëve	2019	2020	Kosto administrative				IShPSHSH
2. Trajnimi i inspektorëve të punës për inspektimin e punës së fëmijëve.	Ulja e rasteve të fëmijëve në punësim të paligjshëm; IShPSHSH referon pranë NJMFsë përkatëse raste të fëmijëve të punësuar që kanë nevojë për mbrojtje		2019	2020	2,000,000 Lekë		X		
3. Takime periodike dhe koordinim në terren midis inspektoriatit dhe PMF-ve.	IShPSHSH referon pranë NJMFsë përkatëse raste të fëmijëve të punësuar që kanë nevojë për mbrojtje; Nr. i fëmijëve të referuar dhe ndjekur	Nr. i takimeve të përbashkëta; Numri i planeve të mbrojtjes për rastet që kanë nevojë për mbrojtje.	2019	Në vazhdim	Kosto administrative				AShMDF, IShPSHSH



4. Aktivitete ndërgjegjësuere për të drejtat për fëmijët e punësuar në sektorin formal.	Fëmijët kanë informacion mbi të drejtat e tyre si edhe kushtet e punësimit për fëmijët; fëmijët njohin mekanizmat e ankesës dhe mbrojtjes.	Nr. i fëmijëve të ndërgjegjësuar	2019	2020					AShMDF, IShPSHSh
---	--	----------------------------------	------	------	--	--	--	--	------------------

Objektiv 3:

Rritja e numrit të çështjeve penale të suksesshme në lidhje me shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve, detyrimin për të punuar; Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nga strukturat ligjzbatuese.

Mjetet për të arritur objektivin: Ekspertizë për ndryshimet në legjislacionin penal në lidhje me shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve; hartimi I udhëzuesve institucionalë të posacëm; takime koordinuese mes strukturave të ndryshme ligjzbatuese; trajnime.

Nënobjektiv 1:

Rritja e numrit të rasteve që ndiqen penalisht për autorët e dyshuar të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve.

Organi/et zbatues/e:

MB,MD, DPPSH, DPV, ASHMDF, Organizatat Ndërkombëtare, OJF-të.

Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pa mbuluara	
1. Ndryshimi i neneve 124/b dhe 128/b të Kodit Penal për të parashikuar qartë shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve dhe trafikimin e brendshëm të fëmijëve.	Legjislacioni penal është në përputhje me Konventat e ILOs; Konventën e KE për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore; Direktivën Anti-Trafikim të BE-së.	Ndryshimi i dispozitave përkatëse në Kodin Penal; Hyrja në fuqi e neneve të ndryshuara	2020	2021					MShMS, MB, MD
2. Trajnime për hetime pro-aktive për punonjësit e strukturave ligjzbatuese (strukturat e policisë).	Rritja e identifikimit të rasteve dhe e dënimit të autorëve të veprave penale të Keqtrajtimit dhe trafikimit të fëmijëve.	Nr. i punonjësve ligjzbatues të trajnuar për përdorimin e teknikave proaktive të hetimit; Numri I ndjekjeve penale për keqtrajtim dhe trafikim të miturish.	Në vazhdim	Në vazhdim					MB, DPPSH, AShMDF, Akademia e Sigurisë.



3. Përgatitja e udhëzuesve dhe komentare për trajnimet me prokurorë dhe gjyqtarë.	Rritja e njohurive të profesionistëve të drejtësisë mbi shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve dhe mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve.	Miratimi I udhëzuesve dhe manualëve të posaçëm nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme.	2019	2020					MD, Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme
4. Në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, trajnime të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rretheve për veprat penale të lidhura me shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve.	Rritja e njohurive të profesionistëve të drejtësisë mbi shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve dhe mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve.	Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve që marrin trajnim të specializuar.	2019	2020					Shkolla e Magjistraturës, MShMS, MD

Nënobjektiv 2

Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shkëmbimit të informacionit lidhur me ndjekjen penale për veprat e lidhura me shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve.

Organi/et zbatues/e

MB, DPPSh, ASHMD, Drejtoritë Vendore të Policisë, Bashkitë.

Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pa mbuluara	
1. Takime periodike ndër institucionale midis MSHMS, MB.	Institucionet ligjzbatuese dhe ato të ndihmës shoqërore koordinojnë rregullisht për identifikim, referimin dhe ndjekjen e rasteve	Numri i takimeve koordinuese, procesverbalet e takimeve.	2019	Në vazhdim					MShMS, MB, DPPSh, Bashkitë.



2. Trajnime / ëorkshope me PMF dhe anëtarë të GTN-ve për procedurat e kallëzimit penal të rasteve të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve.	Rritja e njohurive dhe aftësive të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve mbi mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik.	Numri dhe përqindja e strukturave të mbrojtjes së fëmijës që janë trajnuar mbi aktet ligjore dhe nënligjore në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik; procedurat e identifikimit, referimit dhe menaxhimit të rasteve.	2019	Në vazhdim			X		MShMS, MB, DPPSh, Bashkit, Avokati i Popullit.
3. Takime koordinimi dhe shkëmbim informacioni çdo 3 muaj mes ASHMDF, ZKKAT, Policisë së Shtetit, ishps për mënyrën e identifikimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht.	Përmirësimi i bashkërendimit për referimin e rasteve; shkëmbimi i rregullt i informacionit.	Numri i takimeve periodike në çdo bashki.	2019	Në vazhdim					

Objektiv 4: Barrierat shoqërore dhe kulturore që nxisin shfrytëzimin ekonomik janë ulur.

Mjetet për të arritur objektivin: Fushata ndërgjegjësuë, shpërndarje informacioni në institucionet që u shërbejnë fëmijëve, fushata në mjedise publike të frekuentuara nga fëmijët; Përdorimi i medias audio-vizive dhe të shkruara, medias sociale, etj. Vlerësim dhe rishikim i kurrikulave të arsimit parauniversitar.

Nënobjektiv 1:

Fëmijët, prindërit dhe publiku i gjerë janë të informuar për të gjitha format e shfrytëzimit ekonomik, rreziqet që sjell tek fëmija si edhe mënyrat marrjes të ndihmës.

Organi/et zbatues/e

MShMS, ASHMDF, MASR, MB, OJF-të, Bashkitë, Media, etj.

Aktivitetet	Rezultatet pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pambuluara	
1. Fushata ndërgjegjësuë kombëtare për ditët 12 Prill (dita e FSRR), 12 qershor (dita kundër punës së fëmijëve) 20 nëntor (dita e të drejtave të fëmijëve).	Publiku i gjerë është i ndërgjegjësuar për rreziqet nga shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve përfshirë FSRR.	Nr. i fushatave, nr. i qytetarëve të informuar.	2019	2021				X	MShMS., ASHMDF, MASR, MB, OJF-të, Bashkitë.



2. Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informuese për rreziqet e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve përfshirë FSRR.		Nr. dhe përmbajtja e materialeve të përgatitura	2019	2021					
3. Emisione televizive mbi punën e dobishme përkundrejt shfrytëzimit ekonomik përfshirë FSRR (vendore, kombëtare)		Nr. i emisioneve, artikujve	2019	Në vazhdim					
4. Mbajtja në funksion 24/7 të linjës kombëtare për këshillim.			2019	Në vazhdim					
4. Aktivitete ndërgjegjësuëse komunitare		Nr. i aktiviteteve komunitare	2019	Në vazhdim					

Nënobjektiv 2

Zhvillimi i temave për rrezikun dhe mbrojtjen nga shfrytëzimi ekonomik të fëmijëve përfshirë FSRR në orët e edukimit qytetar dhe orët e lira të kurrikulës së arsimit parauniversitar. MASR, DAR ZA, ASHMDF, NJMF-të, OJF-të, Shkollat.

Aktivitetet	Rezultatet pritshme	Treguesit	Afatet Kohore		Totali i Buxhetit	Burimet e financimit			Monitorim Vlerësimi
			Fillimi	Mbarimi		Buxheti i shtetit	Donatorë	Të pa mbuluara	
1. Trajnime me mësuesit për rreziqet dhe mënyrat e mbrojtjes nga shfrytëzimi ekonomik	Mësuesit kanë dhe japin njohuritë e duhura	Nr. i mësuesve të trajnuar, nr. i temave të trajtuara	2019	Në vazhdim					
2. Zhvillimi i orëve të mësimi/ ose orëve të lira me tematikë shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve.	Fëmijët marrin njohuritë e nevojshme dhe kuptojnë rreziqet nga shfrytëzimi ekonomik. Ata njohin shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve.	Nr. i fëmijëve që kanë akses në njohuritë për shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve	2019	Në vazhdim					



ANEKS 1 DOKUMENTACIONI I MARRË NË SHQYRTIM

- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (2017–2020) (ASHMDF, MMSR dhe UNICEF);
- E ardhmja e Sistemit të Integruar për Mbrojtjen e Fëmijës në Shqipëri (2016, MMSR, ASHDMF dhe KE);
- Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës nr. 18/2017, (përfshirë aktet nënligjore);
- Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, dhjetor 2016 (përfshirë draftet dhe aktet nënligjore);
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur;
- Kodi i familjes (përfshirë aktet nënligjore);
- Kodi i Punës (përfshirë aktet nënligjore);
- Konventa e të Drejtave të fëmijës;
- Konventa e ILO nr. 38 për Moshën Minimale të Punës;
- Konventa e ILO nr. 182 për Format më të Këqija të Punës së Fëmijës;

- Komenti 21, i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, për Fëmijët në Situatë Rruge;
- Vlerësim i masave për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi, shfrytëzimi dhe migrimi i parregullt në Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, 2016, (ASHMDF, OSCE);
- Puna e fëmijëve, një analizë e situatës së punës së fëmijëve në Shqipëri (Save the Children, Avokati i Popullit, SEDA);
- Studimi Kombëtar mbi fëmijët në situatë rruge në Shqipëri, 2014 (UNICEF, Save the Children, ARSIS, GFK);
- Hartëzimi dhe analiza e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, 2015 (Tdh, UNICEF);
- Raport për Zbatimin e Strategjisë kundër Trafikimit të Personave dhe Planit të Veprimit 2014–2017, 2016, (MPB, WVA);
- Raportet e monitorimit të zbatimit të PVFSRR-së (ASHDMF);
- Udhëzim nr. 7, datë 28.2.2018, i ministrit të Financave “për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

ANEKS 2 LISTA E INFORMATOREVE KYÇ

Profesionistët të cilët i janë përgjigjur pyetësorit të mbyllur mbi hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik:

Pyetësorit i janë përgjigjur 36 punonjës për mbrojtjen e fëmijës:

Nr.	Bashkia/Njësia Administrative	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës
1	Dajt/Bashkia Tiranë	Adela Madhi
2	Farke/Bashkia Tiranë	Grejsi Anamali
3	Synej/Bashkia Kavaje	Albana Salillari
4	Bashkia Pustec	Lindita Kitani
5	Bashkia Lezhë	Nermina Shehi
6	Njësia Administrative Kuman/Roskovec	Elis Apostoli
7	Njmf 8/Bashkia Tiranë	Vinjola Syla
8	Njmf 9/Bashkia Tiranë	Lorena Cela
9	Bashkia Kolonjë	Arjola Guda
10	Njmf 3/Tiranë	Erisa Babasuli
11	Bashkia Mirdite	Arselajda Pepkolaj
12	Petrelë/Tiranë	Elone Ferhati
13	Njmf 6/Bashkia Tiranë	Blerina Hysi
14	Njmf 10/Bashkia Tiranë	Emi Lamllari



15	Njmf 4/Bashkia Tiranë	Redona Rustemaj
16	Bashkia Maliq	Totila Hajdini
17	Bashkia Vlorë	Elpiniqi Gjikhuri
18	Bashkia Krujë	Anisa Topalli
19	Bashkia Librazhd	Diola Malasi
20	Bashkia Cërrik	Eglantina Braho
21	Bashkia Korçë	Elenica Tarusha
22	Ndroq/Tiranë	Elmira Shehi
23	Bashkia Kurbin	Kristiana Nezha
24	Bashkia Klos	Lumturie Versula
25	Njësia Administrative Bicaj	Orjola Guri
26	Bashkia Dropull	Albana Curi
27	Njësia Administrative Orikum	Klementina Curoj
28	Bashkia Gjirokastrë	Florian Berberi
29	Bërzhitë/Tiranë	Ledja Bajrami
30	Bashkia Kukës	Elsa Murataj
31	Bashkia Vorë	Denisa Shabanllari
32	Njësia Administrative Xhafzotaj/Bashkia Shijak	Merita Dollaku
33	Bashkia Mat	Doruntina Lala
34	Njmf 2 / Bashkia Tiranë	Eva Dako
35	Bashkia Belsh	Ersida Ferhati
36	Njësia Administrative Sukth/Durrës	Adelina Kurti

Drejtorja e Antitrafikut pranë Ministrisë së Brendshme ka ndare për plotësim me Departamentin e Kufirit dhe Migracionit dhe drejtoritë vendore të Policisë pyetësozin e mbyllur. Pyetësorit i janë përgjigjur Departamenti i Kufirit dhe Migracionit dhe 5 drejtori vendore të Policisë:

Nr.	Institucioni	Punonjës
1	Departamenti për Kufirin dhe Migracionin	Elidon Cela
2	D.V.P Kukës	Gramoz Lencka
3	D.V.P Korçë	Luan Hamzallari
4	D.V.P Durrës	Arben Tare
5	D.V.P Dibër	Hamdi Hasi
6	D.V.P Berat	Aurel Lipe
7	D.V.P Lezhë	Arben Ujka

Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka ndarë për plotësim me drejtoritë e shërbimeve sociale rajonale dhe institucionet e përkujdesit rezidencial për fëmijë. Pyetësorit i janë përgjigjur 10 Drejtori të Shërbimit Social Rajonal dhe 5 institucione të përkujdesit rezidencial për fëmijë:



Nr.	Institucioni	Punonjës
1	Shtëpia e foshnjës Durrës	Renada Pepaj
2	Shtëpia e foshnjës Tiranë	Eva Pojani
3	Shtëpia e foshnjës “Lulet e vogla” Korçë	Klementina Gjecka
4	Qendra e zhvillimit rezidencial Durrës	Jetmir Hoxha
5	Qendër ditore me fëmijë me Ak	Ariana Skllavi
6	Për t’u verifikuar me MSHMS	Olta Ganaj
7	Shërbimi Social Rajonal Tiranë	Manjola Kaci
8	Për t’u verifikuar me MSHMS	Fatmir Vojvoda
9	Shërbimi Social Rajonal Berat	Ervisa Alimi
10	Për t’u verifikuar me MSHMS	Elda Lusha
11	Shërbimi Social Rajonal Korçë	Irena Bozda
12	Shërbimi Social Rajonal Gjirokastrë	Madgalena Margariti
13	Për t’u verifikuar me MSHMS	Anila Shenjtoll
14	Shërbimi Social Rajonal Shkodër	Eltjon Boshti
15	Shërbimi Social Rajonal Dibër	Sonila Braha

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka ndarë për plotësim me Organizatat: Save the Children, Terre des Hommes, Ëold Vision, SHKEJ, ARSIS, VATRA, ARSIS, të ndryshëm dhe të barabartë.

Pyetësorit i janë përgjigjur 3 OJF:

Nr.	Organizata
1	ADRA
2	Të ndryshëm dhe të barabartë
3	SHKEJ (dy qendra ditore Engjëjt e vegjël dhe Eden)

Janë realizuar 15 intervista me profesionistë dhe fëmijë të cilët kanë dalë nga situata e shfrytëzimit ekonomik:

Nr.	Institucioni	Intervista
1	MSHMS	Drejtoria e Politikave dhe Përfshirjes sociale – Merita Xhafaj
2	MB	Koordinator Antitrafik - Anila Trimi
3	Bashkia Shkodër	Drejtor i Shërbimit social në bashki – Filip Vila
4		Punonjës për mbrojtjen e fëmijës - Rudina Kruja
4		5 fëmijë në situatë ruge të vendosur në institucion për kujdesi rezidencial – Shkodër
5	Bashkia Fier	Punonjës për mbrojtjen e fëmijës - Alma Agalliu
6		Punonjës Sociale të qendrës Komunitare Drizë
7	Bashkia Vlorë	Drejtor i Shërbimit social në bashki – Irena Stasa
8		Punonjës për mbrojtjen e fëmijës – Elpiniqi
9		Drejtues dhe Punonjës të Qendrës Vatra
10		Dy fëmijë viktime të shfrytëzimit ekonomik rezidentë të Qendrës Vatra
11	Bashkia Korçë	Punonjës për mbrojtjen e fëmijës – Elenica Tarusha
12		Punonjës Sociale të Qendrës Kenedi
13	Bashkia Bulqizë	Drejtor i Shërbimit social në bashki – Haxhi Pulja
14		2 fëmijë të identifikuar në mbledhje kromi përreth minierave
15	Bashkia Elbasan	Punonjës për mbrojtjen e fëmijës – Nadire Kreka



Pjesëmarrës në *fokus group*:

Nr.	Pjesëmarrës	Institucioni/ Oj
1	Jonita Kabashi	ASHMDF
2	Edvina Murati	ASHMDF
3	Ditmir Lita	ARSIS/Nisma
4	Ardit Reka	Nisma
5	Lorena Cela	Njmf nr. 9
6	Rabije Marku	Njmf nr. 11
7	Denisa Bakiasi	Njmf nr. 7
8	Redona Rustemaj	Njmf nr. 4
9	Hergert Koroveshi	Shkej
10	Taulant Gegolli	(Të ndryshëm dhe të Barabartë)
11	Silva Vllaka	(Qendra Komunitare Shkozë)
12	Orjalda Xhaholli	World Vision
13	Shpresa Cara	Punonjëse Sociale, Bashkia Kavajë
14	Sonila Duda	Punonjëse Sociale, Bashkia Kavajë
15	Ermira Zhuka	Punonjëse terreni, Bashkia Tiranë
16	Anila Zylfi	Koordinatorë e Skuadrave të terrenit, Bashkia Tiranë
17	Olta Rajku	Punonjëse terreni, Bashkia Tiranë

VENDIM

Nr. 151, datë 14.10.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELVA 2001” SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MIVAS” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1940 kW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1 germa “a”, nenit 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2019, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Elva

2001” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 92/11, datë 8.10.2019, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Elva 2001” sh.a, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, nga HEC “Mivas” me kapacitet të instaluar 1940 kW,

konstatoi se:

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 604 prot, datë 1.10.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kW.

- Aplikimi i shoqërisë “Elva 2001” sh.a, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gerrat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gerrat: “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht.



- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1; pika 4.1.2; pika 4.1.3; pika 4.1.4, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5, germat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar pjesërisht.

-Shoqëria “Elva 2001” sh.a, është një subjekt tregtar i krijuar me vendimin nr. 25441 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe mban numër identifikimi NUIS: K12809402J.

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a, është mbajtëse e Miratimit Përfundimtar për ndërtimin e objektit, hidrocentrali “Mivas” me kapacitet prodhues 1940 kW, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Tomorricës, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan me nr. 2657/2 prot, datë 27.12.2017, mbështetur në pikën 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar.

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a, ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Kontratën për ndërtimin e objektit, hidrocentrali “Mivas”, me kapacitet prodhues 1940 kW, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Tomorricës, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan me nr. 5 rep, nr. 3/3 kol. datë 25.1.2018.

- Referuar afateve të vënies në punë të veprës, sipas kontratës sipërcituar, mbajtësi i miratimit merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 21 (njëzetë e një) muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç është parashikuar në grafikon e punimeve të paraqitur në aneksin 2, bashkëlidhur kontratës.

- Rezulton se shoqëria ka vijuar me aplikimet për pajisjen me lejet në institucionet përkatëse.

- Shoqëria, në aplikimin e saj, parashikon të vërë në punë Hec-in në datë 1.12.2019.

Për mungesën e dokumentacionit të konstatuar që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “g”: dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti, kontrata shit-bleje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti).

- Subjekti ka depozituar Kontratën “Për dhënie në përdorim të tokës pa frut” me nr. 1728 prot, datë 6.7.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Skrapar dhe shoqërisë “Elva 2001” sh.a, e cila në nenin 6 të saj ka të parashikuara afatin, i cili rezulton se ka përfunduar më 6.7.2019, me të drejtë ripërsëritje, dhe për këtë shoqëria do të bëjë me dije nëse ka nënshkruar një kontratë të re.

- Neni 9, pika 4.1.1 (Të dhëna specifike për HEC-in)

- Në këtë formular subjekti ka lënë pa plotësuar, pikën 3 të tij (vendndodhja numri i regjistrimit të pronës); pikën 8 (gjatësia e kanalit të derivacionit); pikën 11 (numri i njërive gjeneruese dhe fuqia e instaluar e secilës); pikën 16 (rendimenti); pikën 19 (jetëgjatësia e pritshme e centralit).

- Neni 9, pika 4.1.4, germa “e” (Miratim i projektit të zbatimit nga organi i caktuar me ligj)

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit të sipërcituar, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

- Kontrata për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Mivas” me kapacitet prodhues 1.940 kW, në pellgun ujëmbledhës të lumit Tomorricës, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan dhe Autoritetit Kontraktues, me nr. 5 rep. dhe nr. 3/3 kol, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ka një afat 49-vjeçar, por në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ERE mund të lëshojë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat deri në 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Elva 2001” sh.a, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kW.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 152, datë 14.10.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE
NDRYSHIMEVE NË “RREGULLOREN
PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E
SHPËRNDARJES”, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 166, DATË 10.10.2016, I
NDRYSHUAR, ME VENDIMIN NR. 177,
DATË 8.11.2016 TË BORDIT TË ERE-s,
“PËR PËRCAKTIMIN DHE MIRATIMIN
E TARIFAVE PËR LIDHJEN E
IMPIANTEVE VETËPRODHUESE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA DIELLI”**

Në mbështetje të nenit 10, pika 2; nenit 16 dhe nenit 27, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe neni 21, pika 2, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2019, pasi shqyrtoi relacionin nr. 92/12 prot, datë 11.10.2019 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave në ‘Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes’”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016 të bordit të ERE-s, “Për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhues të energjisë elektrike nga dielli”,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a, me shkresën nr. 16759 prot, datë 31.7.2019 (protokolluar në ERE me nr. 503 prot, datë 2.8.2019), ka paraqitur kërkesën “Për

miratimin e propozimit mbi caktimin e tarifave për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total deri në 500 kWp”.

- Shoqëria OSHEE sh.a, e mbështet këtë kërkesë në zbatim të detyrave të udhëzimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3, datë 20.6.2019 “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”.

- Ligji nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” në neni 15, pika 4 të tij, përcakton se: “Ministri miraton me udhëzim një procedurë të lehtësuar për autorizimin për lidhjen në sistemin e shpërndarjes së projekteve të vogla të energjisë së rinovueshme.”

- Specifikimet e posaçme që udhëzimi nr. 3, datë 20.6.2019 “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes së projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”, ka dhënë në lidhje me aksesin e lehtësuar për këtë kategori, rregullat për aksesin e kësaj kategorie në rrjet, duhet të jenë të ngjashme me ato për lidhjet e reja, të miratuara me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016 të bordit të ERE-s.

- Tarifat për lidhjen me rrjetin shpërndarës të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total deri në 500 kW, për të cilat ka aplikuar OSHEE sh.a, duhet të parashikohen si pjesë integrale e rregullores së lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes, të miratuara me herët me vendimin e bordit të ERE-s, sipërcituar.

- Duke mbajtur në konsideratë se tarifatat për lidhjet e reja të impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike, do të jenë pjesë e rregullores për lidhjet e reja të miratuara nga ERE-ja me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, e ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, do të duhej të paraqitej për miratim si pjesë e rregullores së lartpërmendur nga ana e operatorit të rrjetit të shpërndarjes edhe drafti i procedurave “Për lidhjet e reja të impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike”, si dhe marrëveshja e lidhjes.

- Nga analiza e tarifave të propozuara nga



OSHEE sh.a, për lidhjen e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli, të dërguara për miratim nëpërmjet shkresës nr. 16759 prot, datë 31.7.2019, vërehet se ato kanë të njëjtin emërtim dhe përmbajtje si ato të miratuara me “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, të bordit të ERE-s, të cilat paraqiten si vijon:

T1- Tarifa e studimit dhe vlerësimit të miratimit të projektit ;

T2- Tarifa e distancës ;

T3- Tarifa e fuqisë (lekë/kW fuqi e kërkuar);

T4- Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes.

-Vlerat e propozuara nga shoqëria për tarifën T1, T2, T3 dhe T4 për vetëprodhuesit deri 500 kWp (termi kWp nënkupton kilovatpik, i cili shpreh kapacitetin e instaluar në kushtet e pikut, për sa i përket fluksit, temperaturës dhe spektrit diellor) Pra një impiant me kapacitet 500 kWp në kushtet e pikut, gjatë një ore do të prodhojë 500 kwh.), të lidhur në nivelet respektive të tensionit, paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

Emertimi	Njësia	Lidhje në TU 0.4 kV	Lidhje në TM (6/10/20kV)	Lidhje në TM (35 kV)	Shtesë fuqie, modifikim ose transferim	
					TU (0.4 kV)	TM (35 kV & 6/10/20kV)
T1- Tarifa e studimit dhe vlerësimit të miratimit të projektit	lekë	5,000	23,000	23,000	5,000	23,000
T2-Tarifa e distancës	lekë	-	-	-	-	-
T3-Tarifa e fuqisë (lekë/KW fuqi e kërkuar)	lekë	-	-	-	-	-
T4-Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes	lekë	5,288	5,288	5,288	5,288	5,288

- OSHEE sh.a. nuk i ka mbështetur vlerat e propozuara me analiza në lidhje me kostot për çdo element të tarifave T1 e T4 si dhe nuk ka paraqitur argumentim mbi aplikimin e tarifave me vlera të njëjta si ato të miratuara në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”. Në mbështetje të përcaktimeve të Rregullores në fjalë, Tarifa T4 përbëhet nga komponente të tillë si:

1. Tarifa për azhurnimin e rrjetit;
2. Tarifa për shpenzime administrative;
3. Tarifa e verifikimit/kolaudit fillestar të matësit referuar parashikimeve të nenit 77, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

- Nga sa më sipër, shoqëria OSHEE sh.a, nuk ka paraqitur analiza, në lidhje me vlerat e komponentëve përbërës të tarifës së propozuar (T4 = 5,288) sipas ndarjes së evidentuar më lart.

- Në mungesë të këtyre analizave, shoqëria do të duhej të argumentonte arsyen e paraqitjes së vlerave të tarifave T1 e T4 të njëjta me tarifën respektive të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes pavarësisht faktit që këto tarifa të propozuara kanë të bëjnë me akomodimin e një teknologjie ndryshe me aparatura më të avancuara.

- Në lidhje me tarifën T1 (Tarifa e studimit dhe vlerësimit të miratimit të projektit) për klientët/vetëprodhues të lidhur në TU në nivelin 0.4 kV, konstatohet se është propozuar vlera prej 5000 lekësh e cila është vlera më e madhe ndër dy tarifën për:

- klientët familjarë prej 1000 lekë,
- klientët jo-familjarë prej 5000 lekë,

Nga ato të miratuara në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”.

- Ligji nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” i jep të drejtë për instalimin e paneleve diellore për nevoja vetë-konsumi edhe klientëve familjarë, kapaciteti i konsumit të të cilëve është normalisht më i ulët se bizneset apo klientët e tjerë jo-familjarë në TU. Shoqëria OSHEE sh.a. duhet të argumentojë propozimin për aplikimin e tarifave të njëjta për klientët familjarë me kapacitete konsumi/prodhimi shumë më të vogla se ato të klientëve jo-familjarë.

- I njëjti konstatim vlen edhe për sa i takon tarifën T4 (Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjeve të reja dhe matjes) të cilën shoqëria e propozon me të njëjtën vlerë si për matës monofazë edhe për matës 3 fazor: 5,288 lekë.



- Nuk është argumentuar nga OSHEE sh.a, vlera e propozuar për tarifën T1 në rastin e shtesës së fuqisë, modifikimit të lidhjes ose transferimit.

- Është e paqartë se si do të veprohet në rastet kur klientët e rinj kërkojnë njëkohësisht lidhje të re në rrjetin e shpërndarjes dhe lidhje për impiantet vetëprodhuese fotovoltaike.

- Operatori i transmetimit dhe operatori i shpërndarjes sigurojnë aksesin në rrjetin e tyre, në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

- Për sa më sipër, propozimi i OSHEE për shqyrtimin e vlerave të propozuara për tarifën T1, T2, T3 dhe T4 për vetëprodhuesit deri 500 kWp, të lidhur në nivelet respektive të tensionit gjykojmë që duhet të vijë si disa shtesa dhe ndryshime të “Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016 të bordit të ERE-s,

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016 të bordit të ERE-s, “Për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli» me kapacitet total deri në 500 kW (bashkëlidhur studimi).

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

STUDIMI I TARIFAVE PËR LIDHJEN E IMPIANTEVE VETËPRODHUESE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA DIELLI

1. Tarifat e aplikuara në rastet e lidhjeve të reja me rrjetin shpërndarës janë si mëposhtë:

T1 – Tarifa e studimit dhe vlerësimit të miratimit të projektit;

T2 – Tarifa e distancës;

T3 – Tarifa e fuqisë (lekë/kw fuqi të kërkuar);

T4 – Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes.

Shoqëria OSHEE sh.a, për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli me kapacitet deri në 500 kWp, propozon aplikimin e tarifave si mëposhtë duke përjashtuar tarifën e distancës dhe atë të fuqisë me arsyetimin që këto tarifa janë paguar nga ana e klientit, në procesin e lidhjes si konsumator me rrjetin shpërndarës.

Tarifat T1 (Tarifa e studimit dhe vlerësimit të miratimit të projektit) dhe T4 (Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes) do të jenë të njëjta me ato të aprovuara në “Rregulloren e lidhjeve të reja në sistemin e shpërndarjes” miratuar me vendimin nr.166, datë 10.10.2016 të bordit të ERE-s, e ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016 të bordit të ERE-s, PJESA IV: TARIFAT PËR LIDHJET E REJA

4.6. Tarifat për lidhje në tension të ulët

Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të ulët 0.4 kV:

b) Konsumatorët

T1 = 5000 lekë

T2 = 0 lekë

T3 = 0 lekë

T4 = 5288 lekë

4.7 Tarifat për lidhje në tension të mesëm

Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të mesëm 6, 10 dhe 20 kV

T1 = 23 000 lekë

T2 = 0 lekë

T3 = 0 lekë

T4 = 5 288 lekë

4.8 Tarifat për lidhje në tension të mesëm 35 kV

Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të mesëm 35 kV



T1 = 23 000 lekë

T2 = 0 lekë

T3 = 0 lekë

T4 = 5288 lekë për matës 3 fazor

4.9 Tarifat për shtesë fuqie, modifikim ose transferim

b) Konsumatorët në tension të ulët

T1 = 5 000 lekë

T2 = 0 lekë

T3 = 0 lekë

T4 = 5 288 lekë për matës 3 fazor

c) Konsumatorët në tension të mesëm

T1 = 23 000 lekë

T2 = 0 lekë

T3 = 0 lekë T4 = 5288 lekë

d) Konsumatorët në tension 35 kV

T1 = 23 000 lekë

T2 = 0 lekë

T3 = 0 lekë

T4 = 5288 lekë

VENDIM

Nr. 153, datë 21.10.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELECTRAL BATRA HPP” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 95/2 prot, datë 18.10.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 511

prot, datë 13.8.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 131, datë 29.8.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 32/38 prot, datë 30.8.2019, si dhe me shkresën nr. 515/1 prot, datë 30.8.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Shoqëria ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 511/3 prot, datë 16.9.2019 dhe nr. 511/4 prot, datë 7.10.2019, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,



VENDOSI:

1. Të licençojë shoqërinë ELECTRAL BATRA HPP sh.p.k, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë